

INPO

Initiative for progress

ANALIZË
RAPORTET E AUDITORIT TË
PËRGJITHSHËM DHE KOMUNAT:
MES INJORIMIT DHE ZBATIMIT

PRISHTINË, TETOR 2011

HYRJE

Parimi i llogaridhënies, efikasitetit dhe transparencës në shpenzimin e financave publike janë parime që burojnë nga Kushtetuta dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Institucionet publike, qofshin ato lokale ose qendrore janë të obliguara t'u përmbahen këtyre parimeve, sa herë që në realizimin e qëllimeve të tyre shpenzojnë paratë publike. Ato janë të obliguara t'u përbëhen këtyre parimeve edhe në çdo raport tjetër me qytetarët që jo domosdoshmërisht përkthehet në terma financiar.

Tri vite pas shpalljes së pavarësisë, Kosova si shtet iri vazhdon të përballet me kritika të shumta dhe jo të lehta për mënyrën se si i shpenzon paratë e taksapaguesve. Keqmenaxhimi, kontrolli jo i duhur dhe keqpërdorimi i parasë publike, sipas Raportit të Progresit për vitin 2010 të Komisionit Evropian, është një problem në rritje. Përveç KE-së edhe Banka Botërore kishte bërë vërejtje të ngjashme, mirëpo përkundër kësaj nuk është vërejtur ndonjë përmirësim në të gjitha nivelet e qeverisjes, sidomos në atë lokal.

Një prej mekanizmave mbikëqyrës dhe njëkohësisht matës të mënyrës së shpenzimit të parasë publike nga ana e institucioneve lokale të qeverisjes, janë raportet vjetore të auditimit të pasqyrave financiare të komunave nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP). Përveç auditimit ZAP çdo vit ofron edhe rekomandime konkrete për komunat të cilat duhet të adresohen në mënyrë që problemet e evidentuara nga ZAP të eliminohen. Mirëpo, adresimi i këtyre rekomandimeve nuk bëhet në mënyrën e duhur ose nuk bëhet fare nga ana e komunave, duke përsëritur kështu gabimet e njëjta me ato të një viti më herët dhe duke mos ndryshuar situatën për të mirë në shpenzimin e parasë publike.

Prandaj, kjo analizë do të përqendrohet kryesisht në këtë çështje, sa Komunat i kanë adresuar rekomandimet e mëhershme të ZAP dhe sa kanë arritur progres në eliminimin e problemeve të evidentuara nga ZAP. Gjithashtu, kjo analizë shqyrton dhe raportet e ZAP me Komunat e Kosovës në adresimin e problemeve të evidentuara gjatë auditimit të pasqyrave financiare të komunave.

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Pas shpalljes së Pavarësisë ZAP-i është ndër pak institucionet publike që vazhdojnë të jenë nën menaxhimin e zyrtarëve ndërkombëtarë.¹ Qëllimi mbrapa kësaj pa dyshim ishte ruajtja e pavarësisë dhe efikasitetit në punën dhe rolin që e zhvillon ZAP-i gjatë auditimit të financave publike.

Sipas ligjit në fuqi *Auditori i përgjithshëm në bazë vjetore kryen auditim të Rregullsisë të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, organizatave buxhetore, duke përfshirë por pa u kufizuar, Kuvendin e Republikës së Kosovës, Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës, çdo ministri dhe agjenci ekzekutive, komunitat, organet e pavarura, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) dhe subjektet e tjera të cilat janë më shumë se 50% në pronësi publike ose marrin mjete financiare nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës, sigurojnë dividendët apo të ardhura të tjera të pataksueshme për të, duke përfshirë por pa u kufizuar, Shërbimin Doganor të Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Ombudspersonin.*²

Korniza ligjore dhe kompetencat e kufizuara që ka institucioni i ZAP-it e minimizojnë efektin e raporteve dhe rekomandimeve që dalin nga ky institucion. Ligji Nr. 03/L-075 për themelimin e ZAP-it është shumë i gjeneralizuar dhe ka vetëm tetë (8) faqe, ku theksohen kompetencat dhe detyrat që ka ky institucion i pavarur si institucioni më i lartë i kontrollit financiar.³

ZAP-i aktualisht luanë vetëm dy role: atë të monitorimit dhe dhënies së rekomandimeve të cilat shpesh herë nuk zbatohen nga institucionet e shtetit të Kosovës.

Mungesa e pavarësisë financiare e kufizon ZAP-in në kryerjen e obligimeve ligjore.⁴ Kjo zyrë mund të jetë funksionale vetëm në atë nivel sa ka edhe mjete financiare. Garanca për mos korruptim dhe punë efikase është edhe qëndrueshmëria financiare e zyrtarëve të ZAP-it. Qeveria ende mund të ndikojë në buxhet dhe shpenzime të këtij institucioni.⁵

Megjithatë kemi pasur disa veprime shumë progresive që janë ndërmarrë nga ZAP-i që nga viti 2009, si p.sh. hyrja në fuqi e disa dokumenteve shtesë për të krijuar një sistem profesional të auditimit duke u bazuar në standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira të auditimit⁶:

- Manuali i Auditimit të Rregullsisë
- Strategjia për Zhvillim të Përbashkët
- Udhëzues për Auditim të Performancës
- Udhëzues i menaxhimit të cilësisë së auditimit⁷

¹Propozimi Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, 26 mars 2007, Aneksi IX, neni 2.2.a, fq. 58.

²Ligji Nr. 03/L-075, Neni 3.2 -- Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Auditorit të Përgjithshëm, fq. 3.

³Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 136 (2008).

⁴Raporti i Progresit për Kosovën 2011, 4.2.7.fq.48. (Komisioni Evropian)

⁵Po aty.

⁶Po aty.

⁷Standardet e auditimit: <http://oag.rks-gov.net/shqip/standardet.htm>

KOMUNA E PRISHTINËS

Është Komuna që më së shumti ka në dispozicion buxhet krahas komunave të tjera i cili megjithatë nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur nevojat e qytetit. Përveç kësaj, për shkak të menaxhimit jo-efikas, kryeqyteti vazhdon të ballafaqohet me shumë probleme. Qytetarët e kësaj komune vazhdojnë të kenë kërkesa të shumta për kushte më të mira për jetesë, kryesisht në lidhje me infrastrukturën dhe kërkesa për shërbime më të mira publike.

Komuna e Prishtinës ka qenë në vazhdimësi e kritikuar për mënyrën se si i ka menaxhuar fondet publike sidomos kur bie fjala në ndarjen e prioritetëve. ZAP-i pas çdo auditimi ka dhënë vërejtje dhe rekomandime.

Mirëpo për shkak të rolit të kufizuar që ka ky institucion për ti obliguar Komunitat në përmbushjen e rekomandimeve, Komuna e Prishtinës ka bërë shumë pak progres në përmbushjen e rekomandimeve. Në vitin 2008, ZAP-i ka dhënë njëzet e katër (24) rekomandime prej tyre pesë (5)⁸ janë plotësuar pjesërisht në bazë të kërkesës së këtij institucioni. Përderisa për vitin 2009 prej dhjetë (10) rekomandimeve dy (2) janë plotësuar tërësisht dhe dy (2) të tjera janë pjesërisht të plotësuar.⁹

Komuna e Prishtinës ka një qasje shumë të ngadaltë dhe jo koherente. Për dy vite Komuna e Prishtinës ka marrë tridhjetë (30) rekomandime për të cilat thuhet se në atë periudhë vetëm shtatë (7) janë plotësuar pjesërisht dhe dy (2) plotësisht.

Komuna e Prishtinës në bazë të raporteve të ZAP-it edhe në vitin 2009 dhe 2010 vazhdon të ballafaqohet me shumë mangësi duke filluar prej kontrollit të dobët të brendshëm apo ndryshe përgjegjësisë së ulët menaxheriale. Raportimi i jashtëm dhe i brendshëm vazhdon të jetë sfidë për Kryeqytetin, dhe delegimi i drejtë dhe transparent i kompetencave është një pikë që vazhdon ta shqetësojë ZAP-in.

Zyra e Prokurimit vazhdon të jetë e kritikuar nga ZAP-i në raportin e fundit të këtij institucioni kërkohet forcimi i masave të kontrollit të brendshëm në fushën e prokurimit publik duke e respektuar në tërësi Ligjin për Prokurim Publik (LPP).¹⁰

Zyra e prokurimit gjatë vitit 2009/10 nuk është treguar efiças në monitorimin e projekteve me rëndësi të cilat kanë qenë edhe të kushtueshme. Në mungesë të monitorimit edhe puna që është realizuar dhe dorëzuar në Komunën e Prishtinës ka qenë e cilësisë jo të mirë.

Parapagimi i kontraktorëve me të cilët komuna ka pasur kontrata është një problem shumë serioz në vitin 2010, ku 75% janë për parapagesë për blerjet përderisa punët dhe furnizimi ishte vetëm deri në 35%.¹¹ Veprimet e tilla rrezikojnë cilësinë dhe efiçasitetin e punës. Komuna e Prishtinës duhet të bëjë pagesa në formë të balancuar me punën dhe mallrat që i pranon.

⁸ Raporti i Auditorit të Përgjithshëm, Komuna e Prishtinës 31 dhjetor 2009 fq.8

⁹ Raporti i Auditorit të Përgjithshëm, Komuna e Prishtinës 31 dhjetor 2010 fq.7

¹⁰ Po aty.

¹¹ Po aty. fq.8

Situatë problematike paraqitet me rastin e planifikimit dhe ekzekutimin e buxhetit. Përkundër faktit se Komuna e Prishtinës ka nevoja të mëdha për investime për shkak të gjendjes mjaft të rëndë Komuna e Prishtinës në shumë raste del me suficit në fund të vitit apo duke shpenzuar pjesën më të madhe të buxhetit në fund të vitit fiskal.

Mënyra jo-proporcionale e shpenzimit të buxhetit vazhdon të jetë kritika që Komunën e Prishtinës e përcejll vazhdimisht. Në vitin 2009 Komuna e Prishtinës është kritikuar që nuk ka shpenzuar në mënyrë eficiente buxhetin, vetëm 85% e buxhetit është shpenzuar, ndërsa suficiti ka qenë në vlerë prej 8.5 mil. euro¹², para që nëse ishin shfrytëzuar sipas planifikimit do të ndikonin në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Trendi i njëjtë vazhdon të jetë edhe për vitin 2010, Komuna e Prishtinës në këtë vit në periudhën e katërt në tre muajt e fundit ka shpenzuar 48%¹³ të buxhetit. Kjo formë e shpenzimit të parasë publike është jo efikase duke e dëmtuar edhe planifikimin buxhetor si tërësi i cili hartohet për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm.

KOMUNA E FERIZAJT

Është komuna e tretë më e madhe në Republikën e Kosovës sa i përket numrit të banorëve. Gjatë viteve të fundit Komuna e Ferizajt ka qenë shume herë objektiv i kritikave për funksionim demokratik, transparencë dhe shpenzim efikas të parasë publike si nga institucionet që monitorojnë shpenzimet publike, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile.

Komuna e Ferizajt ka dështuar të krijoj një koncept të drejtë mbi mënyrën e shpenzimit të financave publike. Transparenca dhe llogaridhënia edhe pse janë pjesë e parimeve dhe obligimeve kushtetuese kur vie puna tek shpenzimi i fondeve publike Komuna e Ferizajt ka zgjedhur që ti anashkalojë këto parime.

Rekomandimet që kanë dalë nga ZAP-i në të shumtën e rasteve janë injoruar dhe nuk janë marrë parasysh apo thjeshtë janë plotësuar vetëm pjesërisht. Komuna e Ferizajt vetëm në raportin e fundit të auditorit të përgjithshëm ka injoruar gjashtë (6) rekomandime nga nëntë (9) të dhëna në vitin 2009¹⁴. Ndërsa në raportin paraprak vërejmë një shqetësim nga ZAP-i ku disa rekomandime që ishin dhënë në vitin 2006 nuk ishin plotësuar as në vitin 2009 dhe vetëm njëra nga rekomandimet është plotësuar pjesërisht.¹⁵

Kjo Komunë ka marrë edhe vërejtje të vazhdueshme nga ZAP mbi formën e zbatimit të procedurave të prokurimit publik duke i mos respektuar ato në tërësi apo duke i anashkaluar ato. Komuna e Ferizajt ende nuk ka krijuar mekanizma që mbikëqyrin kontratat në vlera të mëdha në përgjithësi monitorimi i zbatimit të kontratave ka dështuar.

¹² Raporti i Auditorit të Përgjithshëm, Komuna e Prishtinës 31 dhjetor 2009 fq.9

¹³ Raporti i Auditorit të Përgjithshëm, Komuna e Prishtinës 31 dhjetor 2010 fq.8

¹⁴ Raporti i Auditorit të Përgjithshëm, Komuna e Ferizajt 31 dhjetor 2010 fq.8

¹⁵ Raporti i Auditorit të Përgjithshëm, Komuna e Ferizajt 31 dhjetor 2009 fq.8

Komuna e Ferizajt ka qenë e detyruar të dërgojë raste në gjykatë për shkak të mos përmbushjes së obligimeve nga kontraktori. Në këto raste Komuna e Ferizajt ka dështuar që të bejë përzgjedhjen e kompanisë më të mirë dhe nuk e ka monitoruar punën e tyre deri në atë masësa që ka stagnuar implementimi i Projektit.

Komuna e Ferizajt ka dështuar që të implementoj shpenzimin e buxhetit në bazë të vetë-planifikimit, ku si rezultat i kësaj buxheti është shpenzuar në mënyrë jo proporcionale. Vetëm në tre mujorin e fundit Komuna e Ferizajt ka shpenzuar buxhetin e vitit 2010 për 61% kjo dëshmon se ka dobësi në proceset e planifikimit, menaxhimit dhe realizimit të buxhetit.¹⁶

Dhe kjo formë e menaxhimit është trashëguar nga praktikat e viteve paraprake edhe vazhdon të jetë si e tillë.

KOMUNA E PRIZRENIT

ZAP-i gjatë auditimit të pasqyrave financiare, transaksioneve financiare dhe menaxhimit financiar ka identifikuar dobësi pothuajse në të gjitha fushat kryesore, të cilat duhet të adresohen urgjentisht nga menaxhmenti i komunës. Një varg parregullsish që janë bërë gjatë vitit 2010 janë si pasojë e viteve të kaluara e të cilat vazhdojnë të përsëriten nga viti në vit. ZAP-i për të gjitha parregullsitë që janë bërë gjatë vitit 2009 i ka dhënë dymbëdhjetë (12) rekomandime.¹⁷

Ndër të gjeturat dhe rekomandimet janë kontrollet jo të duhura dhe të pamjaftueshme në lidhje me të hyrat vetanake të komunës, avanset për udhëtime zyrtare janë menaxhuar në mënyrë jo adekuate, ka mangësi edhe në kontrollet e brendshme për sa i përket prokurimeve nga të cilat mund të rritet rreziku i keqpërdorimit, detyrimet e pa paguara në afatin e përcaktuar kohorë në vlerë mbi 2,000,000 €¹⁸, një shumë e paguar në vitin 2009 ishte detyrim kontingjent po ashtu edhe Auditimi i Brendshëm ka nevojë për forcim.

Auditimin për vitin 2010 të cilin e ka bërë Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka gjetur disa parregullsi, ku disa prej tyre janë të njëjtat më vitin 2009. Ndër to është parregullsia në menaxhimin financiar. Për parregullsitë e gjetura të vitit 2010 ZAP-i i ka rekomanduar komunës që të sigurojë adresimin e të gjitha rekomandimeve të dhëna të vitit 2009 dhe 2010, hartimin e pasqyrave vjetore financiare në përputhje të plotë me udhëzimet e nxjerra nga Thesari, rritjen e kontrolleve të duhura me harmonizimin e të hyrave ndërmjet departamenteve dhe drejtorisë së financave, t'i kushtohet vëmendje e veçantë zhvillimit të proceseve të prokurimit dhe kontrolleve lidhur me prokurimet, vendosjen e kontrolleve në lidhje me menaxhimin e detyrimeve të pa paguara dhe shpalosjen korrekte të detyrimeve kontingjente, të merren masa të menjëhershme mbi menaxhimin e pasurive dhe njësitë funksionale të Auditimit të Brendshëm.

KRAHASIMET

¹⁶ Raporti i Auditorit të Përgjithshëm, Komuna e Ferizajt 31 dhjetor 2010 fq.10

¹⁷ Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Prizrenit për vitin 2010 fq. 4

¹⁸ Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Prizrenit për vitin 2009 fq. 4

Komuna e Prizrenit nuk ka aplikuar mekanizma të duhur kontrolli mbi gjendjen e të hyrave dhe në një situatë të tillë nuk është e mundur të bëhen barazimet mbi të hyrat sipas evidencave kontabël dhe sistemit të faturimit¹⁹. Në vitin 2009 janë paguar 81,460 € në emër të shpenzimeve për udhëtime zyrtare. Ne kemi rishikuar gjithsej nëntë (9) raste të avanseve dhe në asnjë rast nuk kemi gjetur se aprovimit të kërkesave për udhëtim zyrtar i paraprinte ndonjë agjendë për vendet e vizituara. Komuna nuk ka bërë kontrolle të brendshme prokurimi ku është raportuar në dy vite me radhë i njëjti problem. Komuna e Prizrenit nuk i ka paguar detyrimet në afatin e përcaktuar kohor. Komuna nuk ka adresuar tetë (8) rekomandimet nga dymbëdhjetë (12) sa janë dhënë nga ZAP-i për vitin 2009, po ashtu nuk ka bërë hartimin e pasqyrave vjetore financiare në përputhje të plotë me udhëzimet e nxjerra nga Thesari.

KOMUNA E PEJËS

Nga raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Pejës, shohim se komuna përballet me një mori problemesh. Vërejtjet kryesore i takojnë sferës së menaxhimit të brendshëm të komunës, shkeljeve të rregullave të prokurimit dhe keqpërdorimit të parasë publike.

Komuna e Pejës për vitin punues 2010 kishte marrë pesë (5) rekomandime nga Zyra e Auditorit²⁰, nga të cilat asnjëra prej tyre nuk është realizuar. Kjo tregon jo gatishmërinë e Komunës së Pejës për të avancuar kualitetin punues së saj.

Gjatë vitit 2010 Komuna e Pejës ka realizuar suksesshëm shpenzimin e Buxhetit të saj, buxheti i Komunës së Pejës²¹ për vitin 2010 ka qenë 16,777,770€, shpenzimet totale për vitin 2010 ishin 15,588,842€ apo rreth 93%e buxhetit final.

Pasqyrat Financiare janë hartuar në përgjithësi konform Udhëzimit Administrativ²², por ka lëshime në paraqitjen e llogarive të arkëtueshme dhe pasurive fikse.²³ Problem me të cilin akoma Komuna e Pejës përballet janë mos regjistrimi i të hyrave²⁴, ku bëjnë pjesë edhe të hyrat vetanake të komunës. Mungesa e mbajtjes së regjistrave sipas ZAP²⁵ ndikon që menaxhmenti të mos ketë pasqyrë të besueshme për gjendjen e të hyrave vetanake.

Komuna e Pejës ka pasur një performancë të dobët në kontrollin e brendshëm edhe atë të Prokurimit Publik. Vetëm gjatë vitit 2010 janë vërejtur një sërë parregullsish në keqpërdorimin e parasë publike, si lidhja e kontratës pa fonde të mjaftueshme dhe sigurim të vlefshëm të ekzekutimit, financime të projekteve pa mbikëqyrjen e duhur, dhe mos kryerjen e projekteve sipas dinamikës së punëve.²⁶

¹⁹Po aty.fq.13

²⁰Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Pejës për vitin 2010, fq.7

²¹Po aty.fq. 8

²²Urdhëresë Administrative Nr 20/2009 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore

²³Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Pejës për vitin 2010 fq.9

²⁴Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Pejës për vitin 2009, fq. 11

²⁵Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Pejës për vitin 2010 fq.11

²⁶Po aty.fq.12

Poashtu Komuna e Pejës nuk ka treguar performancë të mirë edhe në ndarjen e subvencioneve. Mjetet janë dhënë pa respektuar kriteret në bazë të së cilave ndahet një subvencion.²⁷ Komuna e Pejës deri më tani nuk ka të formuar komitetin e Auditimit të Brendshëm, gjë e cila i është rekomanduar Komunës së Pejës në raportin e ZAP-it të vitit 2009.²⁸

Procesin e auditimit e kryen Njësia për Auditim të Brendshëm e cila gjatë vitit 2010 nuk ka treguar efektivitet në procedimin e punëve audituese. Gjatë tetë mbledhjeve të saj për këtë vit ajo, është marrë vetëm me auditimin e vitit 2009²⁹, duke anashkaluar tërësisht vitin 2010.

KOMUNA E GJAKOVËS

Komuna e Gjakovës në raportet vjetore të Auditorit gjeneral për vitin 2009-2010 del të ketë mangësi dhe vërejtje të konsiderueshme në shumë fusha. Këto kritika konsistojnë në mos efektshmërinë e Komunës që të realizojë në mënyrë të suksesshme sugjerimet dhe rekomandimet e dhëna nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Sipas ZAP³⁰, Komuna e Gjakovës vazhdon akoma të përballet me të njëjtat probleme, për të cilat ka marrë gjithnjë rekomandimet dhe sugjerimet e duhura nga ana e saj si institucion. Sipas Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm Komuna e Gjakovës ka mangësi në përgatitjen e Pasqyrave Financiare në mënyrë profesionale dhe ngecje e paqartësi edhe në raportimin financiar, ku me këtë rast komuna rrezikon integritetin e informacioneve dhe të dhënave financiare dhe shfrytëzimin pa leje të aseteve e shërbimeve të saja nga palët e tjera.³¹ Poashtu shqetësuese është edhe mos regjistrimi gjithëpërfshirës i pronave dhe patundshmërive të komunës.³² Kjo gjë krijon mundësinë që komuna të mos ketë qasje në shfrytëzimin e duhur të aseteve të veta.

Komuna e Gjakovës në vitin 2009 ka marrë gjithsej pesë (5) rekomandime, ku del të ketë plotësuar në mënyrë të suksesshme vetëm një (1) rekomandim³³, atë të regjistrimit të të hyrave komunale. Të gjitha rekomandimet e tjera kanë pasur ngecje në realizim dhe implementim.

Komuna e Gjakovës gjatë vitit 2009/10 nuk ka pasur planifikim të duhur në nisjen dhe menaxhimin e projekteve kapitale, poashtu ka rrezikuar realizimin e kontratave duke hyrë në marrëdhënie kontraktuale pa pasur fonde të mjaftueshme. Në sektorin e blerjeve përmes Prokurimit, Komunën e Gjakovës e karakterizojnë shumë parregullsi si fillimi i shumicës së projekteve pa zotimin e fondeve, projekte të filluara e të pa përfunduara, mungesë e evidencave për nivelin e projekteve të realizuara, apo edhe hyrja në kontratë pa sigurim të ekzekutimit.³⁴

Poashtu janë realizuar shumë shpenzime të pa nevojshme dhe pa as një bazë ligjore duke rënduar në këtë formë buxhetin komunal dhe rrjedhimisht taksapaguesit e Qytetit si: pagesa e artikujve

²⁷Po aty.fq. 13

²⁸Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Pejës për vitin 2009 fq.20

²⁹Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Pejës për vitin 2010 fq.16

³⁰Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Gjakovës për vitin 2009 fq.6

³¹Po aty.fq.7

³²Po aty.fq. 8

³³Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Gjakovës për vitin 2010 fq.7

³⁴Po aty.fq. 12

jashtë listës së specifikacionit teknik, pranimi i mallit vetëm nga një person, avansi i paguar për udhëtime jashtë vendit, pagesa nga vendimet gjyqësore.³⁵

Sfidë shqetësuese mbetet edhe siguria jo e mjaftueshme në kontrollin e brendshëm financiar³⁶, kontrolli i tanishëm ka shfaqë shumë dobësi në analizimin dhe sanimin e duhur të parregullsive në komunë. Poashtu në Komunën e Gjakovës sipas ZAP, nuk ka cilësi të mirëfilltë të Auditimit të Brendshëm, duke theksuar së në këtë rast NJAB e Gjakovës gjatë vitit 2010, nuk është marrë fare me dy nga pikat më të rëndësishme siç janë: prokurimi dhe të hyrat komunale.³⁷

Kjo tregon se Auditimi i Brendshëm në Komunën e Gjakovës ka mangësi në kryerjen e rregullt të punës. Në raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2010, Komuna e Gjakovës ka marrë gjithsej dhjetë (10) rekomandime³⁸ për secilën fushë përkatëse, ku janë evidentuar të meta dhe parregullsi.

KOMUNA E MITROVICËS

Komuna e Mitrovicës është një nga shtatë (7) qendrat kryesore të Kosovës dhe njëherit si qendra e dytë më e rëndësishme e cila renditet menjëherë pas Kryeqytetit. Mirëpo Komuna e Mitrovicës në krahasim me qendrën kryesore Prishtinën ka një buxhet 40% më të vogël.

Në përgjithësi, buxheti i Komunës së Mitrovicës ka pasur një trend stabil të rritjes që nga viti 2003, përveç në vitin 2007 kur ka shënuar rënie prej rreth 5% në krahasim me vitin paraprak (2006).³⁹ Paralelisht me rritjen e buxhetit të përgjithshëm ka ecur edhe trendi i rritjes së rrogave dhe mëditjeve, të cilat gjithashtu përbëjnë më shumë se gjysmën e buxhetit të kësaj komune.

Buxheti i Komunës së Mitrovicës për vitin 2009 numëronte 11,5 milion euro, prej të cilave vetëm 11.5% janë të hyra vetanake të kësaj komune.⁴⁰ Edhe në vitin 2009, më shumë se gjysma e buxhetit të kësaj komune ishte e planifikuar të shpenzohej në rroga dhe mëditje.

Po ashtu edhe për vitin 2010 është një situatë e njëjtë ku kjo komunë ka në dispozicion 12,867,390 Euro⁴¹, ku prapë më shumë se gjysma e buxhetit është planifikuar të shpenzohet në paga dhe mëditje.

Pra edhe për kundër këtij buxheti që posedon Komuna e Mitrovicës nuk ka arritur ti përmbushë kërkesat bazë të qytetarëve. Një shqetësim i tillë vjen edhe nga raportet vjetore të Auditorit gjeneral për vitin 2009-2010, ku vërehet të ketë mangësi dhe vërejtje të konsiderueshme në shumë fusha.

³⁵Po aty.fq.13

³⁶Po aty.fq.16

³⁷Po aty.fq.17

³⁸Po aty.fq. 9-17

³⁹Instituti për Studime të Avancuara GAP, Mitrovica – Raporti Komunal 2009, fq.8

⁴⁰Po aty.

⁴¹Buxheti i Komunës së Mitrovicës për vitin 2010: <http://kk.rks-gov.net/mitrovica/Projects/Budget.aspx>

Këto kritika konsistojnë në mos efektshmërinë dhe mos planifikimin e mirë të Komunës për shpenzimin e parasë publike, dhe në mos efektshmërinë që të realizojë në mënyrë të suksesshme sugjerimet dhe rekomandimet e dhëna nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.⁴²Sipas Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm Komuna e Mitrovicës ka mangësi në përgatitjen e Pasqyrave Financiare në mënyrë profesionale dhe ngecje e paqartësi edhe në raportimin financiar.⁴³

Po ashtu probleme dhe rekomandime vërehen edhe në sistemin e kontrollit të brendshëm, menaxhimit të pasurisë, të hyrat, dhe prokurimi. Shqetësues është fakti i mos pasjes të një sistemi të kontrollit të brendshëm më eficient, poashtu Komuna e Mitrovicës nuk posedon asnjë regjistër të veçantë për regjistrim të asetëve të veta, njëherit nuk ka as barazim në mes të departamenteve dhe zyrtarëve të hyrave vetanake, poashtu edhe tek prokurimi vërehet mos pasja e listave kontrolluese, mungesa e komisionit vlerësues, jo transparencë gjatë zhvillimit të vlerësimit të tenderëve, ndarje të tenderëve për të shmangur procedurat e hapura, benificionet e dhëna pa dokumente mbështetëse të duhura, dhe mungesa e dosjeve në dokumentet e prokurimit.⁴⁴

Nga katër rekomandimet e marra nga raporti i Auditorit të Pavarur, Komuna e Mitrovicës nuk ka arritur të përmbushë asnjërin nga ta. Për kundër kësaj shqetësues është fakti që të gjitha këto rekomandime rrjedhin që nga viti 2008 në vitin 2009 dhe nga neglizhenca dhe mos efikasiteti këto rekomandime barten edhe në vitin 2010 dhe që të gjitha mbeten të pa realizuara.⁴⁵

REKOMANDIMET

- 1) Komunat duhet të zbatojnë në tërësi rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm të evidentuara në raportet vjetore të auditimit të pasqyrave financiare.
- 2) Komunat duhet të menaxhojnë me paratë publike duke u bazuar në parimet kryesore të evidentuara në standardet e menaxhimit dhe të auditimit të shpenzimeve publike.
- 3) Komunat duhet të ngrisin kapacitetet e brendshme të auditimit dhe kontrollit financiar.
- 4) Duhet të fuqizohet edhe më tutje kontrolli i jashtëm i shpenzimeve të parasë publike duke krijuar mekanizma të përgjegjësisë dhe llogaridhënies.
- 5) Duhet të fuqizohet transparenca dhe efikasiteti i Zyrave të Prokurimit Publik nëpër komuna.
- 6) Prokuroritë Publike duhet të hetojnë ato raste ku Auditori i Përgjithshëm ka evidentuar parregullsi ose keqmenaxhim të parasë publike.
- 7) Komunat duhet të shpenzojnë buxhetin konform planifikimeve paraprake që do të ndikonte në minimizimin e suficitit vjetor.

⁴²Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Mitrovicës për vitin 2009, fq.28

⁴³Po aty.

⁴⁴Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Mitrovicës për vitin 2010, fq. 28-42

⁴⁵Po aty. fq. 28-29

INICIATIVA PËR PROGRES - INPO
RRUGA NENA TEREZE NR. 30/B2 | PRISHTINË, 10000 KOSOVË
TEL: +381 (0) 38 220 552 | +377 (0) 44 746 749
WWW.INPO-KS.ORG | E-MAIL: INFO@INPO-KS.ORG